

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7818  
E martë, 25 qershor 2024  
Çmimi 0.50

## Faqebardhë!



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE



**KUVENDI MAQEDONAS VOTON PËR QEVERINË E RE NË KRYE ME MICKOSKIN** F. 2

**PRESIDENTI I SHOIPËRISË NDEROHET ME TITULLIN "QYTETAR NDERI" I DRENASIT** F. 7

**I AKUZUARI PËR SULM NDAJ KFOR-IT NË ZVEÇAN DËNOHET ME 15 MUAJ BURGIM** F. 7

### EKONOMI



**FILLON ANKETA PAS REGJISTRUESE** F. 8

**DISA VENDE MBESIN PA RRYMË PËR SHKAK TË SHIUT** F. 8

### SPORT



**SHOIPËRIA ME KOKËN LART ELIMOHET NGA EVROPIANI, KUALIFIKOHEN SPANJA DHE ITALIA** F. 10

## E DJATHHTA EKSTREME NË FRANCË SHKAKTON SHQETËSIM DERI NË KOSOVË



Sondazhet, tash për tash, e nxjerrin në epërsi partinë e ekstremit të djathtë, Tubimi Kombëtar, e cila është

thellësisht nacionaliste, euro-skeptike dhe anti-migrante. Sipas një shkrimi në "New York Times", Macroni i dha të

djathtës ekstreme shansin më të mirë për ta qeverisur Francën për herë të parë që nga 'regjimi Vichy' i Luftës së Dytë Botërore

**KOSOVA, NIKOQIRE E KONFERENCËS SË GJYKATAVE SUPREME TË VROPËS, THEKSOHET RËNDËSIA E PAVARËSISË SË GJYQËSORIT** F. 3



INTERVISTË ME AUTOREN SHUKRIJE RAMA

**DHIMBJET NUK MATEN ME VLERË MONETARE** F. 6



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Kuvendi maqedonas voton për qeverinë e re në krye me Mickoskin

**SHKUP, 24 QERSHOR** - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka votuar të dielën në mbledhje qeverinë e re, në krye me liderin e partisë VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski, pas fitores në zgjedhjet e 8 majit. Qeveria e re është zotuar për reforma substanciale në ekonomi dhe luftën kundër korrupsionit. Opozita ka thënë se premtimet qeveritare janë manipulative dhe jo të domosdoshme.

Deputetët kanë votuar me 77 vota për dhe 22 kundër qeverisjes së re. Qeveria e re do t'i ketë 23 ministra në qeveri dhe pesë prej tyre do të jenë edhe zëvendëskryeministra. Në adresimin para votimit në Kuvend, Mickoski ka thënë se "qytetarët janë të lodhur nga argumentet" dhe duan "punë, përkushtim, përgjegjësi dhe hapa konkretë". "Në 100 ditët e para ne do ta rrisim standardin,

do të punojmë shumë, shteti do të ndryshojë", ka thënë Mickoski, duke u zotuar për ulje taksash, rritje të pensioneve, një projekt në vlerë të 250 milionë eurove për komunat, investime të reja dhe luftë kundër korrupsionit. Kabinetin qeveritar do ta përbëjnë 16 ministra prej koalicionit në krye me VMRO DPMNE-në, gjashtë prej koalicionit VLEN dhe dy prej partisë politike ZNAM.



## BE-ja e miraton pakon e re të sanksioneve kundër Rusisë

**BRUKSEL, 24 QERSHOR** - Bashkimi Evropian e ka miratuar të hënën një pako të re të sanksioneve kundër Rusisë për shkak të luftës së saj në Ukrainë. Pakoja e 14-të e sanksioneve kundër Rusisë përfshin ndalimin e rimbushjes së gazit të lëngshëm natyror të Rusisë në BE për qëllime të dërgimit të tij në vendet e treta. Kjo pako i ofron BE-së më shumë mjete për ta luftuar shmangien e sanksioneve. Sanksionet përfshijnë, po ashtu, masa kufizuese ndaj 116 individëve dhe subjekteve të tjera për shkak të veprimeve të tyre kundër Ukrainës. "Sanksionet e reja vënë në shënjestër sektorë të vlerës së lartë të ekonomisë ruse si: energjia, financat dhe tregtia, si dhe e bëjnë tejet të vështirë shmangien e sanksioneve të BE-



së", tha Këshilli i BE-së në një komunikatë. Pakoja e re përfshin edhe ndalimin e përdorimit të Sistemit për Transfer të Mesazheve Financiare (SPFS), një lloj sistemi SWIFT me bazë

në Moskë. Për më tepër, partitë politike dhe organizatat si dhe OJQ-të nuk do të lejohen më të pranojnë financim nga Rusia, tha Këshilli. "Sanksionet ua ndalojnë medieve të BE-së, partive

politike dhe organizatave analitike, të marrin fonde nga burime ruse. Janë vendosur masa edhe kundër kompanive nga Kina, Kazakistani, Kirgistani, Turqia dhe Emiratet e Bashkuara Arabe për anashkalimin e

sanksioneve kundër Rusisë", thuhet në deklaratë. Në njoftim theksohet se Këshilli i BE-së i ngarkon kompanitë evropiane të sigurojnë që partnerët e tyre në vendet e treta të mos i shkelin sanksionet evropiane. "BE-ja kufizon regjistrimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në bllok për qytetarët dhe kompanitë e Rusisë", thuhet në njoftim. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Netanyahu thotë se nuk pranon marrëveshje që i jep fund luftës në Gazë

**JERUSALEM, 24 QERSHOR** - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se është i gatshëm të pranojë vetëm marrëveshje për armëpushim të "pjesshëm", e cila nuk do t'i jepte fund luftës në Rripin e Gazës. Në një intervistë të transmetuar të dielën mbrëmë në kanal in izraelit 14, i cili është pro liderit izraelit, Netanyahu tha se është i gatshëm të bëjë "marrëveshje të pjesshme - kjo nuk është diçka e fshehtë - e cila do të na i kthente neve disa prej njerëzve", duke iu referuar rreth 120 pengjeve që po mbahen ende në Gazë. "Por, ne jemi të përkushtuar për ta vazhduar luftën pas një pauze, në mënyrë që ta përmbushim synimin tonë për eliminimin e Hamasit [grupit të shpallur organizatë terroriste nga ShBA dhe BE]. Nuk jam i gatshëm të heq dorë nga kjo", theksoi

Netanyahu. Komentet e fundit të Netanyahu nuk dallojnë shumë nga ajo çfarë kishte thënë ai në të kaluarën për kushtet që kërkonte për një marrëveshje. Megjithatë, ai i bëri ato në një kohë të ndjeshme, sepse Izraeli dhe Hamas duket se po largohen çdoherë e më shumë nga propozimi më i fundit për armëpushim. Komentet e Netanyahu, gjithashtu, dallojnë shumë me kushtet e marrëveshjes së detajuar në fund të muajit të kaluar nga presidenti amerikan Joe Biden, i cili e cilësoi planin si izraelit dhe të cilit disa në Izrael iu referuan si "marrëveshja e Netanyahu". Komentet e tij mund t'i tensionojnë edhe më shumë marrëdhëniet në mes të Izraelit dhe ShBA-së, aleatit kryesor të



tij. Plani me tri faza kërkon lirinë e të gjitha pengjeve të mbetura në shkëmbim të liritë të qindra palestinezëve të burgosur në Izrael. Por, ka mosmarrëveshje dhe mosbesim në mes të Izraelit dhe Hamasit për mënyrën se si do të zbatohet marrëveshja. Hamasi ngul këmbë se nuk do t'i

lirojë pengjet e mbetura nëse nuk ka armëpushim të përhershëm dhe tërheqje të plotë të forcave izraelite nga Gaza. Kur Bideni e njoftoi për propozimin në fund të majit, tha se marrëveshja i përfshin të dyja këto. Por, Netanyahu thotë se Izraeli është i përkushtuar për ta

shfarosur Hamasin dhe për t'u siguruar se ky grup nuk do të kryejë kurrë më sulm si më 7 tetor. Plani përfshin tri faza për t'i dhënë fund luftës me një plan shumëvjeçar për rindërtimin e Gazës, e cila është rrënuar pothuajse plotësisht si pasojë e luftimeve. Izraeli e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj një sulmi nga Hamasit në jug të Izraelit më 7 tetor, ku u vranë 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe u rrëmbyen rreth 250 të tjerë. Izraeli thotë se më shumë se 100 pengje po mbahen ende në Gazë, së bashku me trupat e pajetë të rreth 30 të tjerëve. Prej atëherë, lufta izraelite në Gazë i ka vrarë më shumë se 37 000 palestinezë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë.



# Kosova, nikoqire e konferencës së Gjykatave Supreme të Evropës, theksohet rëndësia e pavarësisë së gjyqësorit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Gjykata Supreme e Kosovës për herë të parë është bërë nikoqire e Konferencës së 14-të të kryetarëve të Gjykatave Supreme të Evropës Qendrore dhe Lindore. Në këtë konferencë u theksua se është qenësore që sistemi gjyqësor në vend të ketë pavarësinë e tij dhe të jetë i pandikuar.

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi, tha se pavarësia e gjyqësorit është pa dyshim gurthemeli i një demokracie funksionale dhe “është baza dhe çatia e të gjithë shtetit të së drejtës”. Me këtë rast, ai foli edhe për pavarësinë e gjyqësorit, derisa tha se disa herë ka pasur tentativa për ndërhyrje. “Kjo konferencë përfaqëson një mundësi të shkëlqyeshëm për të gjithë ne që shkëmbejmë ide dhe bashkëpunojmë për t'i forcuar sistemet tona gjyqësore nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira juridike. Kjo konferencë po organizohet për herë të parë në Kosovë. Pavarësia e gjyqësorit është pa dyshim gurthemeli i një demokracie funksionale, është baza dhe çatia e të gjithë shteteve të së drejtës pa të cilin parim gjyqësor nuk do ta kishte asnjë kuptim”, tha Rexhepi.

Ulja e pagave të gjyqtarëve, nismat për ndryshime kushtetuese ligjore, ishin disa nga ndërhyrjet që, sipas Rexhepit, ishin bërë nga politika. “Ky parim garanton që gjyqësor të mbetet i lirë nga çfarëdo ndikimi. Ne duhet të punojmë përshtur për ta forcuar e të qëndrojmë vigjilentë për ta mbrojtur këtë pavarësi nga kushdo qoftë. Është



evidente që pushtetet e tjera jo gjithëherë pajtohen me gjyqësorin e pavarur dhe jo pak raste kemi tentativa për të ndërhyrë, me nisma për ndryshime kushtetuese ligjore, me ulje të pagave të gjyqtarëve, qoftë me deklarime publike të qeveritarëve e të tjerë për çështje në shqyrtim në gjykata, që përfaqëson cenim të rend të pavarësisë së gjyqësorit dhe paraqet presion të papranueshëm me punën e gjyqtarit. Pa këtë pavarësi vetë themelet e shoqërive tona demokratike janë të paqëndrueshme dhe rrezikojnë të ardhmen e vet shoqërisë”, tha

ai. Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Gresa Caka-Nimani, tha se kjo konferencë duhet ta përçojë mesazhin esencial - atë të rëndësisë së pavarësisë së pushtetit gjyqësor. “Kontribuon edhe në avancimin e debatit në nivel të gjykatave supreme, gjykatave të larta me qëllim të mbrojtjes efektive të të drejtave dhe lirive themelore. Duke kontribuar edhe në avancimin e vlerave demokratike dhe sundimit të ligjit. Më lejoni të vë theksin në dy pika parësore: rëndësinë e dialogut gjyqësor dhe nevojën që përtej

shkëmbimit të përvojave ky dialog të përçojë një mesazh esencial: atë të rëndësisë së pavarësisë së pushtetit gjyqësor”, tha Caka-Nimani.

Homer E. Moyer, themelues i Institutit “CEELI”, tha se gjyqësori në Kosovë meriton të lavdërohet për punën e rëndësishme që është bërë. “Forcimi i sundimit të ligjit është i rëndësishëm. Para 35 vitesh çdo shtet në këtë rajon ka qenë në qeveritë autoritare, ku sundimi i ligjit nuk është respektuar. Kurse sot dy të tretat e shteteve tuaja rangohen në pjesën e epërme të indeksit të mbarë globit të sundimit të ligjit

që prodhohet çdo vit nga projekti i drejtësisë në botë. Ju meritoni që të lavdëroheni për punën e rëndësishme që keni bërë dhe që është dashur të bëni”, tha ai.

John Walker, gjyqtar i Lartë i Qarkut, tha se juristët, profesorët e juridikut e shoqëritë civile mbrojnë të drejtat e njeriut dhe sigurojnë që demokracitë të vazhdojnë të funksionojnë e t'i transformojnë shoqëritë tona. “Historitë e tërë botës qytetare kanë marrë hapa të rëndësishëm për ta mbrojtur dhe avancuar sundimin e ligjit. Ju keni zgjedhur pesë tema të rëndësishme për këtë”, u shpreh ai.

## Pjesëtarët e KFOR-it trajnohen për kontrollin e trazirave, publikohen pamje gjatë ushtrimeve



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Njësia e Specializuar Shumëkombëshe e Misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, ka zhvilluar aktivitete trajnimit për kontrollin e trazirave të turmave në Prishtinë.

KFOR-i ka publikuar edhe disa fotografi teksa shihen pjesëtarët e karabinierëve italianë duke u trajnuar. “Njësia e Specializuar Shumëkombëshe e misionit KFOR, udhëhequr nga NATO, zhvilloi aktivitete trajnimit për kontrollin e trazirave të turmave në Prishtinë. KFOR-i vazhdon ta zbatojë mandatin e tij bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 për të ofruar mjedis të sigurt për

të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX), me të cilët punojmë ngushtë”, thuhet në njoftim.

93 pjesëtarë të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, u lënduan vitin e kaluar në Zveçan gjatë protestave të qytetarëve të komunitetit serb, të cilët nuk pranorin që kryetarët shqiptarë të komunave të vendoseshin në objektet komunale. Një vit pas protestës, KFOR-i vazhdon të kërkojë që faktet të vërtetohen dhe autorët të mbahen përgjegjës.





# E djathta ekstreme në Francë shkakton shqetësim deri në Kosovë

Sondazhet, tash për tash, e nxjerrin në epërsi partinë e ekstremit të djathtë, Tubimi Kombëtar, e cila është thellësisht nacionaliste, euro-skeptike dhe anti-migrante. Sipas një shkrimi në “New York Times”, Macroni i dha të djathtës ekstreme shansin më të mirë për ta qeverisur Francën për herë të parë që nga ‘regjimi Vichy’ i Luftës së Dytë Botërore

**PRISHTINË, 24 QERSHOR** - “Bixhoz i rrezikshëm” - kështu e përshkruan shumë media perëndimore vendimin e presidentit të Francës, Emmanuel Macron, për t’i shpallur zgjedhjet e parakohshme legislative. Sipas një shkrimi në “New York Times”, Macroni i dha të djathtës ekstreme shansin më të mirë për ta qeverisur Francën - për herë të parë që nga ‘regjimi Vichy’ i Luftës së Dytë Botërore. “Për ata që kanë më shumë për të humbur nga e djathta ekstreme në pushtet - para së gjithash imigrantët dhe pasardhësit e imigrantëve të fundit - lajmi është i tmerrshëm. Macroni, me siguri, shpreson se ky veprim është në dobi të tij. Por, mos gaboni: Franca është në rrezik”, shkroi “New York Times”.

Macroni i shpalli zgjedhjet pasi koalicioni i udhëhequr prej partisë së tij të qendrës, Rilindja, pësoi humbje nga partia e ekstremit të djathtë, Tubimi Kombëtar, në zgjedhjet për

Parlamentin Evropian këtë muaj. Ai shfaqti besimin se populli francez do ta bëjë “zgjedhjen më të drejtë”. “Rritja e nacionalistëve dhe e demagogëve është rrezik për kombin tonë, por edhe për Evropën tonë dhe për vendin e Francës në Evropë dhe në botë”, tha Macroni.

Rrethi i parë i zgjedhjeve do të zhvillohet më 30 qershor, i dyti më 7 korrik.

Sondazhet e opinionit, përfshirë një të publikuar në uebfaqen Le Point, e nxjerrin Tubimin Kombëtar të Marine Le Penit në epërsi, me afro 30 për qind të votave në rrethin e parë. Kjo do të thotë se nga muaji i ardhshëm, Macronit mund t’i duhet të qeverisë me kryetarin e Frontit Kombëtar, Jordan Bardella, si kryeministër.

Bardella përfaqëson gjithçka që Macroni kundërshton: është anti-migrant, euro-skeptik, nacionalist dhe populist.

Në një intervistë televizive më 16

qershor, ai tha se “nuk do të jetë bashkëpunëtor i Macronit” nëse emërohet kryeministër. “Nëse populli francez më beson, unë do t’i drejtoj politikën e vendit përmes propozimeve të qarta, përmes prioritetëve konkrete, fuqisë blerëse, sigurisë, migracionit... Dhe po, dua të ndërtoj një qeveri të bashkimit kombëtar, me njerëz që nuk vijnë domosdoshmërisht nga Tubimi Kombëtar”, tha Bardella.

Zgjedhjet e rregullta parlamentare në Francë do të duhej të mbaheshin në vitin 2027, kur edhe mandati i Macronit skadon. Se përse ai ka vendosur të luajë me zjarrin në këtë mënyrë, ka mendime të ndryshme.

Ish-diplomati francez Pierre Vimont, tani bashkëpunëtor i Institutit Carnegie Europe, thotë se Macroni mund të jetë duke testuar publikun francez dhe aftësinë e ekstremit të djathtë për të qeverisur.

Duke folur për programin Expose të Radios Evropa e Lirë, ai thotë se performanca e Tubimit Kombëtar ka shkuar duke u përmirësuar vitet e fundit për shkak të rritjes së pakënaqësisë sociale me establishmentin. “Arsyeja kryesore e kësaj pakënaqësie - nëse shihen sondazhet e opinionit - ka të bëjë me rënien e fuqisë blerëse dhe me cilësinë e shërbimeve publike. Njerëzit mendojnë se arsimit dhe kujdesi shëndetësor nuk e kanë efikasitetin e njëjtë siç e kanë

pasur. Shtu këtu edhe migrimin! Ata ndihen disi të frikësuar nga migrimi, kanë ndjenjën e humbjes së identitetit të tyre kombëtar”, thotë Vimont.

Sipas një studimi të vitit 2022, “92 % e votuesve të Tubimit Kombëtar besojnë se shumica e imigrantëve nuk i ndajnë vlerat e Francës” dhe se “kjo krijon probleme për bashkëjetesën”.

Për më tepër, shumë në Francë i shohin rregullat e gjelbra të BE-së si barrë për bujqësinë e tyre. Po ashtu, argumentojnë se importet e grurit nga Ukraina - për shkak të koncesioneve të luftës - i kanë dëmtuar tashmë të ardhurat e fermerëve francezë.

Bardella zotohet se do t’i adresojë të gjitha këto.

Vimont thotë se nëse ai e formon qeverinë e re, ndikimi i Macronit në çështjet e brendshme do të zvogëlohej ndjeshëm.

Me Kushtetutën franceze ai do ta mbante rolin kryesor në mbrojtje dhe politikë të jashtme, si dhe do të negocionte traktate ndërkombëtare, por do ta humbiste fuqinë për të vendosur në politikën e brendshme, thotë Vimont. Kjo, sipas tij, do të mund të ndikonte pastaj edhe në çështjet tjera, si mbështetja për Ukrainën, pasi presidentit do t’i duhet miratimi i Parlamentit për ta financuar secilën ndihmë nga buxheti vjetor i Francës.

Vimont thotë se e djathta ekstreme - nëse do - mund t’ia vështrësojë

punën Macronit edhe në politikën e jashtme, së paku deri në një masë. “Tubimi Kombëtar e ka thënë në mënyrë të drejtpërdrejtë se është kundër çdo zgjerimi të ri të BE-së, qoftë me Ukrainën, Moldavinë apo shtetet e Ballkanit. Por, nuk mendoj se do të shkojë menjëherë në konfrontim të drejtpërdrejtë me presidentin për këtë çështje”, thotë Vimont.

Vimont shton se frika në vendet e Ballkanit Perëndimor, që synojnë anëtarësimin në BE, mund të bëhet e pakapërcyeshme nëse Le Pen garon për presidente në vitin 2027 dhe fiton.

Gëzim Visoka, profesor i Studimeve të Paqes dhe Konfliktit në Universitetin e Qytetit të Dublinit, pajtohet se marrja e pushtetit nga partia e Le Penit do të ishte “lajm i keq” për Ballkanin Perëndimor por, sipas tij, kjo nuk do të përkthehej në ndonjë ndryshim radikal të qëndrimeve të BE-së. “Tani, nën dominimin e partive të qendrës së djathtë apo të majtë, zgjerimi nuk është prioritet për BE-në. Është taktikë për ta blerë përkrahjen dhe bashkëpunimin e vendeve të Ballkanit dhe të Evropës Lindore. Nëse gjatë mandatit të ardhshëm të Komisionit Evropian nuk do të ketë ndonjë zhvillim të veçantë, unë mendoj se projekti i zgjerimit - siç e njohim në formën klasike - do të jetë i vdekur”, thotë Visoka për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, fitorja eventuale e partisë së Le



# Projektligji për KPM-në 'bashkon' PDK-në dhe LDK-në, duan ta dërgojnë në Kushtetuese

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend Zemaj, në deklaratën e tij dhënë pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, ka thënë se po vazhdon ajo që e quajti shqetësim nacional, "tendenca e autokracisë në këtë vend" për, siç bërë me dije ai, imponimin e strukturës personale të individëve të caktuar në institucionet e pavarura siç janë KPK-ja dhe KPM-ja.

Ai ka shtuar se nëse nuk ka pajtim të deputetëve, atëherë këto çështje, sipas tij, duhen adresuar në Gjykatën Kushtetuese. "Po vazhdon ajo pjesa që ne e kemi quajtur si shqetësim nacional, tendenca e autokracisë në këtë vend, për imponimin e strukturës personale të individëve të caktuar në institucionet e pavarura siç është Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media dhe shumë agjenci dhe organizata të tjera që janë të pavarura me Kushtetutë. Këto do të kundërshtohen në këtë seancë, nëse nuk ka ndonjë dakordim të deputetëve për ta ruajtur demokracinë, ose për të avancuar, atëherë ne duhet ta adresojmë këto çështje në

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës", u shpreh ai.

Në lidhje me këtë çështje foli edhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, duke thënë se projektligjet për KPM-në dhe KPK-në paraqesin shqetësim të madh.

Te projektligji i Komisionit të Pavarur për Media, u shpreh ai, ka pasur kritika të mjaftueshme si nga shoqëria civile, po ashtu edhe nga zyrtarë të BE-së dhe, sipas tij, nga Këshilli i Evropës.

Tahiri tha se janë duke punuar së bashku me këshilltarët ligjorë të PDK-së që ta shohin mundësinë që këtë projektligj ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese.

"Projektligji i Komisionit të Pavarur për Media dhe është ligji për Këshilli Prokurorial. Këto dy projektligje paraqesin një shqetësim jashtëzakonisht të madh, sidomos te projektligji i Komisionit të Pavarur për Media ka pasur kritika të mjaftueshme edhe nga shoqëria civile, nga zyrtarë të BE-së në Kosovë dhe nga Këshilli i Evropës dhe prej rekomandimeve që kanë ardhur nga Këshilli i Evropës për standardet të cilat duhet të jetë



një projektligj i tillë, nuk janë përputhur pothuajse fare, apo në masën më të madhe janë

injuar. Ky projektligj, fatkeqësisht, është një tendencë e kontrollit të medieve online, të

cilin ne e kundërshtojmë jashtëzakonisht shumë", ka thënë Tahiri.

## Faqebardhë!



SHKUP, 24 QERSHOR - "Faqebardhë!", ka shkruar në "Facebook" Talat Xhaferi pas dorëzimit të detyrës së kryeministrit të pasardhësi Hristijan Mickoski.

Xhaferi ka thënë se vendimi që Maqedonia e Veriut të ketë një kryeministër shqiptar shkroi një ardhmëri të re, ndryshe, më progresive dhe më evropiane për shtetin.

Ai ka bërë me dije se tash do ta ushtrojë funksionin e deputetit. "Në ditën e fundit të punës si kryeministër, detyrimisht rikujtoj vizionin dhe kauzën e kryetarit Ali Ahmeti për kryeministrin e parë shqiptar në Republikën e Maqedonisë së

Veriut. Vendim i cili shkroi një ardhmëri të re, ndryshe, më progresive dhe më evropiane për shtetin tonë. Vendim i cili dëshmoi se puna, përkushtimi dhe rezultatet në favor të të gjithë qytetarëve i tejkalojnë interesin partiak, etnikumin, politikën ditore dhe stuhitë javore. Faleminderit për gjithë mbështetjen dhe profesionalizimin e të gjithëve përreth meje! Shkruam histori, mbetet që gjeneratat më të reja ta vazhdojnë dhe përsosin. Deri në momentet e ardhshme historike për shtetin tonë, qëndroj i përkushtuar në funksionin e deputetit", ka shkruar Talat Xhaferi.

Penit do të mund të kishte ndikim të menjëhershëm në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai thotë se Le Pen ka lidhje me lobet dhe grupet serbe, qoftë në Francë, qoftë jashtë saj.

Flitet se partia e saj është e lidhur edhe me organizatën franceze "Solidarite Kosovo", e cila, siç thuhet në ueb-faqen e saj, punon "në shërbim të të krishterëve të shtypur" në Kosovë. "Duke i marrë parasysh këta parametra të përkrahjes historike politike, mund ta shohim Francën duke marrë një kurs më proserb dhe më kushtëzues ndaj Kosovës, duke u

munduar që t'i vërë asaj kushte shtesë, ose t'ia rikthejë masat ndëshkuese, që duket se do t'i hiqen tash për tash", thotë Visoka. Që Kosova të shpëtojë nga kjo "dinamikë negative", që "shfrytëzon elementin e fesë dhe të identitetit", ai thotë se lidhshipi i ri në BE, që është në krijim e sipër, duhet ta ndryshojë kursin politik. "Për Kosovën është me rëndësi që BE-ja të ketë një qëndrim parimor dhe të përbashkët për shtetësinë e saj. Aktualisht nuk e ka. Shumë probleme që i ndodhin Kosovës me BE-në, me dialogun, vijnë si pasojë e mungesës së një qëndrimi të përbashkët ndaj

shtetësisë së Kosovës. Shpresa ime është që lidhshipi i ri në BE t'i tejkalojë këto mjegulli dhe të ketë një politikë të qartë, afirmative dhe të barabartë ndaj Kosovës, siç e ka me të gjitha vendet e tjera të rajonit", thotë Visoka.

Pesë vende të Bashkimit Evropian - Greqia, Spanja, Sllovakia, Rumania dhe Qiproja - nuk e njohin ende pavarësinë e Kosovës, e cila është shpallur në vitin 2008. E, Këshilli Evropian duhet të votojë unanimisht për një sërë çështjesh, të cilat shtetet anëtare i konsiderojnë si të ndjeshme - përfshirë këtu ato që lidhen me politikën e jashtme dhe të

sigurisë.

Në rastin e Kosovës, Franca ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë, e shpesh edhe vendimtar, në një varg gjërash - nga liberalizimi i vizave deri te Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Gjatë një bisede telefonike në prill, Macron i ka folur kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, edhe për rëndësinë e themelimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Nëse Tubimi Kombëtar fiton shumicën në Francë, kjo do të ishte hera e katërt në historinë e vonë të këtij vendi që do të kishte

'qeveri të bashkëjetesës' - që do të thotë se shumica parlamentare dhe presidenti do të vinin nga grupime të ndryshme politike. Të tilla qeveri janë formuar më 1986 dhe 1993 nën presidentin Francois Mitterrand dhe më 1997 nën presidentin Jacques Chirac. Megjithatë, kësaj radhe mund të jetë ndryshe, pasi Tubimi Kombëtar nuk është parti tradicionale e qendrës së djathtë apo e qendrës së majtë, si në rastet e mëparshme. Ai është një grupim thellësisht nacionalist dhe populist i krahut të djathtë, i themeluar nga babai i Le Penit më 1972.



INTERVISTË ME AUTOREN SHUKRIJE RAMA

# Dhimbjet nuk maten me vlerë monetare



“Libri ‘Mos paç fatin tim’ nuk është libër i rëndomtë. Për më tepër është një dhimbje. Dhe... është e papërballueshme t’i vësh dhimbjes çmim. Kam respektuar integritetin emocional dhe isha e bindur se përvoja e tyre nuk mund të matet me vlera monetare. Prandaj libri dhurohet” - thotë Shukrije Rama, autorja e librit “Mos paç fatin tim”, i cili muaj më parë ka dalë nga shtypi

PRISHTINË, 24 QERSHOR -

**“Epoka e re”:** “Mos paç fatin tim”... Pse ky titull?

**Sh. Rama:** “Mos paç fatin tim” është një titull mjaft intrigues. Sapo libri doli nga shtypi, menjëherë filloi të shkaktonte kureshtje tek lexuesit. Supozonin se është libër autobiografik. Por, në fakt libri përmban rrëfime të njëmendta të grave të cilat kanë përjetuar dhimbje. Ideja për ta titulluar kështu librin lindi shumë spontanisht, në bisedë me një personazh të këtij libri. Duke shpalosur pikëllimin dhe përjetimet për humbjen e bashkëshortit dhe të djalit në luftë, për të njëjtën ditë, pra dy lajme të hidhura brenda një dite, ajo për një çast ndaloi, ofshau thellë dhe tha: asnjë femër në botë mos pastë fatin tim. Ky pikëllim, kjo humbje, kjo dhimbje sikur mu ngulit në mendje dhe assesi ta largoja nga mendja. Dikur thashë: ky qenka titulli i këtij libri. Prandaj, mund të them se titulli “Mos paç fatin tim”, nuk është vetëm një titull. Për më tepër është një dhimbje, një emocion, dhe një ndjenje e pamundësisë për ta ndryshuar fatin.

**“Epoka e re”:** Çfarë përmban libri?

**Sh. Rama:** Ky libër përmban rrëfime të njëmendta në të cilat

shpalosen përvoja jetësore të grave, të atyre që mbijetuan masakrën, të atyre që humbën më të dashurit në luftë. Pastaj shpaloset fati i gruas që jeton në gjakmarrrje, e gruas që u martua në moshën 13 vjeçe, e gruas që përjetoi shumë herë burgun në kazamatet serbe. Në libër shpalosen edhe përvoja të tjera të grave, të keqtrajtuara emocionalisht, të kritikuara vazhdimisht, të quajtura me emra poshtërues, të injoruara, mirëpo edhe të braktisura. Por, jo vetëm kaq. Në libër shpaloset edhe përvoja e gruas që luftoi, që u inkuadrua në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. E asaj që u inkuadrua në Policinë e Kosovës, por edhe e gruas e cila filloi të botojë me pseudonim “Burri” kur zëri i femrës nuk dëgjohej.

**“Epoka e re”:** Ndonëse ky është libri i pestë me radhë, çfarë e dallon këtë libër nga librat e tjerë që keni botuar?

**Sh. Rama:** Pavarësisht prej përvojës sime 25-vjeçare në të shkruar dhe katër librave të botuar deri më tash, ky libër, i pesti me radhë, ishte ndryshe. Rrëfimet e këtij libri veçohen nga çdo gjë që kam shkruar më parë. Përgatitja e këtij libri ishte një sfidë në vete. Rrëfimet brenda këtij libri më ngjallën emocione që nuk i kam

përjetuar kurrë më parë. Pesha e këtyre rrëfimeve ndikoi thellë në mua dhe shpesh e gjeja veten duke u përballur me intensitetin e dhimbjeve.

**“Epoka e re”:** Me çfarë sfidash u

përballët gjatë shkrimit të librit dhe si i tejkaluat ato?

**Sh. Rama:** Ndërsa lexoni faqet e këtij libri, veçanërisht në njërin nga rrëfimet, mund të hasni në tri gabime drejtshkrimore. Nuk është një dëshmi e mungesës së aftësive, por përkundrazi dëshmi e ngarkesës emocionale që mbante ky libër. Studimet themelore dhe ato të magistraturës i kam përfunduar në Fakultetin e Filologjisë, në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, dhe deri më tash kam lekturuar qindra libra universitarë, punime shkencore, monografi, por sa herë i kthehesha atij rrëfimi, ligështohesha sa që kishte momente kur mbyllja me forcë lap-topin dhe i thosha vetes: Mjaft më për sot!. Disa herë e mendova ta dërgoj librin në lekturim, por nëse do ta lekturoja, do të evitoheshin këto gabime dhe bashkë me gabimet do të evitoheshin edhe kujtimet që rikthejnë emocionin e ligësisë së përjetuar gjatë shkrimit të librit.

**“Epoka e re”:** E kuptuam se nga erdhi ideja për titullin e librit, po për vetë librin nga doli ideja?

**Sh. Rama:** Ideja për të shkruar këtë libër lindi nga besimi i thellë se përjetimet e patreguara të grave shqiptare, me përpjekjet dhe forcën e tyre të jashtëzakonshme, duhet të dokumentohen. Këto gra meritojnë të dëgohen dhe përvojat e tyre meritojnë të shërbejnë si dëshmi për sakrificat e tyre jetësore. Çdo rrëfim për të ishte si një monument i ngulitur thellë në shpirt, para të cilit nderonin humbjet, dhimbjet dhe sakrificat e tyre. Prandaj nëse ky

libër nuk do të titullohej “Mos paç fatin tim”, sigurisht do të titullohej “Monumenti i dhimbjes”.

**“Epoka e re”:** Ku qëndron thelbi i këtij libri?

**Sh. Rama:** Thelbi i këtij libri qëndron në ndriçimin e rolit të gruas shqiptare - rol ky që shpesh anashkalohet ose heshtet. Pavarësisht prej mungesës së respektit dhe vlerësimit të duhur, gratë i durojnë sfidat familjare, marrin pjesë në luftëra, rritin fëmijë dhe përpiqen ta zbusin varfërinë brenda familjeve të tyre. Rrëfimet janë një realitet që nuk duhet t’i harrojmë. Edhe pse sot gratë mbajnë pozita si mjekte, arkitekte, inxhinierë, mësuese, shkencëtare, ato vazhdojnë të përballen me çështje që variojnë nga fyerja, nënçmimi, dhuna, madje edhe te vrasja.

**“Epoka e re”:** Po mesazhi i librit?

**Sh. Rama:** Ky libër fton lexuesin për një reflektim të thellë mbi rolin dhe trajtimin e grave në shoqërinë tonë. Libri shpalos një thirrje të qartë: gratë nuk duhet të shihen si shërbëtore, objekte të pavlerë, ose robëri të pashmangshme të caktuara nga normat patriarkale. Emërtimet e tilla janë të frikshme dhe nuk duhet të jenë pjesë e realitetit tonë. Gruaja meriton respekt, vlerësim dhe dinjitet, dhe është koha që shoqëria dhe familjet tona t’ua japin atyre këtë vlerësim. Vetëm duke ua dhënë grave mundësinë për të shkëlqyer dhe për të kontribuar në mënyra të shumta, ne mund të ndërtojmë një shoqëri më të barabartë dhe më të drejtë për të gjithë.





## Presidenti i Shqipërisë nderohet me titullin "Qytetar Nderi" i Drenasit

DRENAS, 24 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, të hënën është nderuar me titullin "Qytetar Nderi" i Drenasit. Këtë titull ai e pranoi nga kryetari i kësaj komune, Ramiz Lladrovci. Në fjalimin e tij, Begaj tha se ky është një moment i veçantë në jetën e tij. "Më lejoni t'i shpreh

falënderimet e mia dhe mirënjohjen e pakufi ndaj popullit të Drenasit dhe autoriteteve lokale, të cilët më bënë këtë nder kaq të madh", tha Begaj.

Kreu i shtetit shqiptar vlerësoi lart kontributin e ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohen në Hagë, për të cilët uroi që të

kthehen sa më parë në familjen e tyre.

Po ashtu, Begaj përmendi edhe kontributin e madh të dëshmorëve për lirinë e Kosovës.

Presidenti i Shqipërisë një ditë më parë është nderuar me të njëjtin titull edhe nga komuna e Deçanit.



## I akuzuari për sulm ndaj KFOR-it në Zveçan dënohet me 15 muaj burgim

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar të hënën me 15 muaj burgim Nenad Orloviqin për përfshirje në sulmin e 29 majit në Zveçan ndaj ushtarëve të KFOR-it. "Departamenti Special ka vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarit N. O. për veprën penale 'sulm ndaj personit zyrtar dhe pjesëmarrja në turmë që kryen veprën penale dhe huliganizmi'", tha Gjykata Themelore në një komunikatë për medie.

Gjykata tha se në dënim atij do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23 qershor 2023, kur ishte arrestuar, që nënkupton se i kanë mbetur edhe tre muaj burgim për t'i kryer. Ai u shpall fajtor dhe u dënua me 6 muaj burgim edhe për një akuzë tjetër penale në lidhje me sulmin, por në marrëveshje me gjykatën vendosi ta zëvendësojë dënimin me burgim me dënim me gjobë prej 12 000 eurove, thuhet në njoftim.

Policia e Kosovës e kishte arrestuar Orloviqin në Mitrovicën e Veriut më 23 qershor 2023, se kishte marrë pjesë në sulmin ndaj KFOR-it, misionit ushtarak të NATO-s në



Kosovë, më 29 maj në Zveçan. Atë ditë të lënduar kishin mbetur rreth 30 ushtarë të KFOR-it gjatë tentimeve për t'i shpërndarë protestuesit e grumbulluar

pranë objektit komunal në Zveçan.

Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë e kishte dënuar arrestimin e Orloviqit.

Protestat në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - filluan më 26 maj 2023, kur grupe të serbëve lokalë

u grumbulluan para objekteve komunale për të protestuar kundër hyrjes së kryetarëve të rinj shqiptarë të Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit në to.

## KRU Prishtina, qytetarëve: Shfrytëzojeni me kujdes ujin e pijshëm!



PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" u ka bërë thirrje qytetarëve ta shfrytëzojnë racionalisht ujin e pijshëm në mënyrë që të ketë ujë të mjaftueshëm për të ardhmen. "Uji sot nuk duhet të shfrytëzohet në mënyrë të pakontrolluar, me ç'rast i zvogëlojmë rezervat e ujit të pijshëm, por uji duhet kursyer pikë për pikë! Vetëm kështu sigurojmë sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të ardhmen", thuhet në njoftimin për medie.

Derisa KRU Prishtina bën thirrje për ruajtjen e ujit, tregon se është duke inspektuar terrenin në rast të keqpërdorimit të ujit dhe kyçjet ilegale. "Sot kemi rritje të kërkesave për ujë të pijshëm, pavarësisht që shpërndarja bëhet në mënyrë të barabartë dhe me kapacitete maksimale trajtuese. Nga ju kërkojmë shpenzim racional të ujit, ndërsa ne jemi duke inspektuar terrenin për kyçje ilegale dhe keqpërdorime të ujit në zonat urbane e rurale", thuhet në njoftimin e KRU Prishtina.

## Pas reshjeve të shiut në kryeqytet, Rama del në terren

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka dalë të hënën në terren për ta parë gjendjen pas reshjeve të dendura të shiut që ranë një

ditë më parë në kryeqytet. "Dolëm në terren për ta vlerësuar situatën dhe për të ndërhyrë në pikat kyçe, në mënyrë që të evitohen dëmet në raste të ngjashme. Pas

konsultimeve me institucionet përkatëse, krijuam shtabin e krizës për menaxhimin e situatës në ditët në vijim, duke marrë parasysh parashikimet për

reshje të ngjashme. Së bashku me zjarrfikësit, ekipet tona të emergjencës kanë ndërhyrë në 100 raste të lajmëruara nga qytetarët", ka thënë ai.





## Fillon Anketa Pas Regjistruese

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të hënën Anketën Pas Regjistruese (APR). Kjo anketë angazhon zyrtarë të pavarur nga procesi i

regjistrimit, dhe aq më shumë zhvillohet në pavarësi të plotë nga procesi i regjistrimit. Anketa Pas Regjistrimit është metodë e cila monitoron të gjitha aspektet e regjistrimit

në terren, si dhe të statistikave në bazën e të dhënave. APR-ja në të vërtetë përdorë pyetësorë të veçantë të zhvilluar veçanërisht për këtë anketë.

Informatat e mbledhura nga pyetësori i APR-së shfrytëzohen për vlerësimin e mbulueshmërisë si dhe për kontrollimin e cilësisë së karakteristikave të përzgjedhura e të



mbledhura gjatë procesit të regjistrimit.

# Mungesa e certifikatave të pronësisë në Shqipëri, pengesë për zhvillim



TIRANË, 24 QERSHOR - Në Shqipëri, megjithëse kanë kaluar më shumë se 30 vjet nga rrëzimi i sistemit komunist, i cili nuk njihje pronën privat, pjesa më e madhe e banorëve që jetojnë në zonat malore, në veri të vendit, vazhdojnë të mos pajisen me certifikatën e pronësisë për banesat dhe tokat e tyre.

Në vitin 1992 ata refuzuan ligjin 7 001 për ndarjen e tokës duke ruajtur kufijtë e vjetër të pronave, çka i la ata pa certifikatë pronësie. Ndërsa në vitin 1991, kur ndryshoi sistemi politik në Shqipëri dhe kur të gjithë krahët e politikës miratuan ligjin 7 501 për ndarjen e tokës, banorët e zonave malore në Veri të Shqipërisë e refuzuan atë dhe u kthyen në tokat dhe trojet e trashëguara nga të parët. Por, kur drejt Thethit,

Valbonës, Vermoshit, Lëpushës, Tamarës, apo Razmës u shfaqën turistët, të shtyrë nga peizazhet alpine, tradita e mikpritjes, veshjet apo ushqimi, pjesa më e madhe prej tyre u përballën me mungesën e certifikatave të pronësisë dhe pamundësinë për zhvillimin e pronës.

Kryetari i Shoqatës "Dukagjini", Ndue Sanaj, i tha "Zërit të Amerikës" se këtë shqetësim ua kanë paraqitur autoriteteve para 20 vitesh, por deri tani nuk është bërë asgjë. "Ne e kemi filluar problematikën e kësaj çështje që në vitin 2008. Fakti është se e gjithë zona e Dukagjinit, ashtu siç kam njohuri unë edhe malet e tjera nuk kanë tapi (certifikatën e pronësisë) për pronat", thotë ai. Drejtuesi i Shoqatës "Dukagjini" thotë se, përveç zonave të

njohura për turizmin malor, edhe në zonat e tjera malore mungesa e certifikatave të pronësisë po pengon zhvillimin. "Janë të regjistruara që në vitin 1947, por tapi (certifikatën e pronësisë) nuk ka askush. Thethi ka probleme sepse është vendi që vijnë turistët, dhe jo pak, por në vendet e tjera në malësi akoma nuk kanë dalë këto probleme, sepse akoma nuk është zhvilluar turizmi", thotë ai.

Nevoja për të investuar në ndërtimin e bujtinave apo rikonstruktimin e kullave ekzistuese i ka përballur banorët me ligjin. Dhjetëra banorë janë ndaluar nga policia dhe proceduar nga prokuroria për ndërtime të jashtëligjshme.

Sipas avokatit Anton Kosteri, mungesa e titujve të pronësisë

vazhdon t'i penalizojë banorët e zonave malore, përfshirë edhe ata të zonave turistike. "Në këto zona do të jetë shumë e vështirë për të bërë investime sepse çdo ndërtim, qoftë edhe një tullë që do të vendoset atje, do të konsiderohet se vendoset në një tokë shtet dhe jo në tokën e tyre të trashëguar prej qindra vitesh, kjo për shkak të mos regjistrimit të titujve të pronësisë", thotë ai.

Por avokati Kosteri thotë se, nëse politika dhe qeveria janë të gatshme për të mbështetur zhvillimin e këtyre zonave të varfra, atëherë mund të gjenden zgjidhje për pajisjen e tyre me certifikatë të pronësisë. "Në këto kushte unë e çmoj të domosdoshme ndërhyrjen e shtetit duke ngritur grupe pune pranë njësive vendore, duke

thirrur edhe persona, banorët më të vjetër, për të përcaktuar së pari kufizimet dhe të drejtën e pronësisë së gjithsecilit, sepse secili banor atje e di se ku e ka pronën e tij. Dhe mendoj që, me ngritjen e këtyre komisioneve me kryetarët e fshatrave, me përfaqësuesit e njësive administrative dhe me ekspertë të fushës, jam i sigurt se gjendet zgjidhja, por nëse ekziston vullneti politik".


Muajin e kaluar kryeministri Rama, gjatë një vizite në qendrën turistike të Thethit, u premtoi banorëve fshirjen e të gjitha gjobave për ndërtimet e paligjshme të bërë ndër vite në mungesë të certifikatave të pronësisë si dhe zgjidhjen e problemeve të pronësisë duke i pajisur me tituj e pronësisë për pronat e trashëguara.

## Disa vende mbesin pa rrymë për shkak të shiut

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kompania për Distribimin e Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) ka njoftuar se pas reshjeve të shiut disa lart-përçues nëpër rajone të ndryshme të vendit të jenë jashtë funksionit. "Rrebeshet e

shiut, të përcjella me erëra e shkarkime atmosferike, vende-vende edhe me breshër kanë bërë që disa lart-përçues nëpër rajone të ndryshme të vendit të jenë jashtë funksionit. KEDS tha se aktualisht rajonet më të

prekura janë Prishtina, Peja, Prizreni dhe Ferizaj. Po ashtu është njoftuar se falë intervenimit të menjëhershëm të KEDS-it, në disa vende ku është stabilizuar moti, disa dalje tashmë janë rikthyer në funksion", ka njoftuar KEDS-i.






# Mbi ndikimin e luftës në letërsi

Nga: **Andrey KURKOV**  
(botuar në korrik 2023 nga  
PEN International me  
titullin *Ukraina, një histori  
për t'u bashkëndarë*)  
Përktheu: Andreas DUSHI

Kur filloi pushtimi i ri rus ndaj Ukrainës në shkurt të 2022, personazhet e romanit që po shkruaja më fluturuan tutje. Në procesin tim letrar, kisha mbetur vetëm dhe po rrija, si t'i kisha duart e lidhura, mes skrivanisë dhe dritares. Në fillim dëgjova shpërthimin e antitankeve ruse, pastaj pashë horrorin në sytë e kalimtarëve në rrugë dhe, duke kontrolluar internetin për lajme, pashë se të gjitha rrugët që të shpien në Perëndim ishin mbushur me qindra-mijëra makina plot me ukrainas që po i shpëtonin luftës.

As nuk ia kisha idenë se çfarë më priste mua dhe familjen time, se çfarë e priste Ukrainën. Nuk e kisha kuptuar se personazhet e romanit tim të pambaruar do të ishin refugjatët e parë nga koka ime, nga apartamenti im dhe nga bota e familjes sonë. Nuk mund ta imagjinoja se ata do të ishin të frikësuar, por fakt është se nuk janë kthyer tek unë, as pasi kanë kaluar pesëmbëdhjetë muaj nga ky pushtim i ri. Që nga 24 shkurti 2022, ky roman ka mbetur i ngjirë në faqen 61.

Me të mbetur pa heronjtë e librit tim, edhe unë u ktheva në refugjat. Jo menjëherë, por hap pas hapi. Në ditën e dytë të luftës, bashkë



me time shoqe hymë në makinë, morëm një mikeshë bashkë me të birin dhe shkuam në shtëpinë tonë në fshat, diku një orë më tutje nga Perëndimi. Sapo kishim filluar të nxirrjm gjërat nga çantat, kur një miku im i vjetër më telefonoi dhe pasi më pyeti ku isha, ulëriti: "Ikni menjëherë nga aty! Tanket ruse po vijnë andej"! U kthyem në makinë dhe u nisëm sërish. Gjatë këtij udhëtimi, kuptova se tani isha unë personazh i një historie rreth luftës dhe largimit prej saj. Gazetarët e huaj që

vazhdonin të më telefononin tekta po i jepja makinës, më ndihmuan ta kuptoja statusin tim të ri. Kështu, fillova të flas rreth aventurës sonë të trishtë, rreth ngecjes tonë natën në vargmalet e dimërta karpate, diku në mes të një trafiku të gjatë shtatëdhjetë kilometra, sesi pika e karburantit ishte bosh dhe se si na duhej të gjenim një vend ku të rrinim. Atëherë nisa ta shkruaja të gjithën dhe u bëra disa heroi joheroik i historisë së vetes sime.

Për pesëmbëdhjetë muajsh, kam

folur rreth vetes dhe Ukrainës, rreth ukrainasve të tjerë që po luftojnë ose i janë larguar luftës si dhe rreth miqve të mi që refuzojnë ta lënë Kievin edhe pse kërcënim i pushtimit rus është tmerrsisht i vërtetë.

Disa histori qëndrojnë përgjithmonë me ata që i tregojnë dhe me ata që i dëgjojnë. Njëra syresh është historia e Volodymyr Vakulenkos. Autori i librave për fëmijë, një baba beqar që kujdesej për të birin me një paaftësi në të mësuar. Volodymyri vendosi mos

ta linte shtëpinë e tij pranë qytetit Iziom. Kur rusët ia pushtuan fshatin, ai qe arrestuar për t'u marrë në pyetje, por më vonë u lirua. Kur u rikthye në shtëpi, mori ditarin e tij të shkruar me shkrim dore, e futi në një qese plastike dhe e proposi në oborr poshtë një peme qershie. Pak ditë më vonë, më 23 mars 2022, ushtria ruse u kthye për të.

Askush nuk e ka parë më të gjallë Volodymyrin. Trupi i tij u identifikua vetëm në nëntor. Dy plumba nga një pistoletë Makarov ia kishin shpuar trupin. Në dhjetor u varros, por atëherë shkrimtarja Victoria Amelina e kishte vizituar fshatin e tij tanimë të çliruar. Prindërit e Volodymyrit i treguan vendin ku shkrimtari i vranë pati propozur ditarët e tij. Ajo gërmoi dhe i nxori që aty. Në ato ditare, Volodymyr Vakulenko parasheh vdekjen e tij në duart e pushtuesve rusë. Tani libri i tij është ribotuar dhe, si shkrimtar, Volodymyr Vakulenko jeton. I flet lexuesit të tij nga faqet e librit. Dhe, tani, tekta ju tregoj për të, edhe unë po ashtu kam ndjesinë sikur ai është gjallë diku jo shumë larg nga këtu.

I kam harruar heronjtë e romanit tim të papërfunduar. Nuk e di kur do të kthehen tek unë dhe kështu të mund ta mbaroj historinë e tyre. Do të ndodhë vetëm pas mbarimit të luftës? Jam mësuar disa me mungesën e tyre. Historia që ata kanë mund të presë. Ka histori më urgjente për t'u treguar. Dhe disa syresh janë për t'u treguar nga unë. /ExLibris/

## Netanyahu: Nuk pranoj marrëveshje që i jep fund luftës në Gazë

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se është i gatshëm të pranojë vetëm marrëveshje për armëpushim "të pjesshëm", e cila nuk do t'i jete fund luftës në Rripin e Gazës.

Në një intervistë të transmetuar të dielën mbrëma në kanalën izraelit "14", i cili është pro liderit izraelit, Netanyahu tha se është i gatshëm të bëjë "marrëveshje të pjesshme – kjo nuk është diçka e fshehtë – e cila do të na i kthente neve disa prej njerëzve", duke iu referuar rreth 120 pengjeve që po mbahen ende në Gazë.

"Por, ne jemi të përkushtuar për ta vazhduar luftën pas një pauze, në mënyrë që ta përmbushim synimin tonë për eliminimin e Hamasit [grupit të shpallur organizatë terroriste nga SHBA dhe BE]. Nuk jam i gatshëm të heq dorë nga kjo", theksoi Netanyahu. Komentet e fundit të Netanyahu-t nuk dallojnë shumë nga ajo çfarë kishte thënë ai në të kaluarën për kushtet që kërkonte për një marrëveshje.

Megjithatë, ai i bëri ato në një kohë të ndjeshme, sepse Izraeli dhe Hamasi duket se po largohen çdo herë e më shumë nga propozimi më i fundit për armëpushim.



Komentet e Netanyahu-t gjithashtu dallojnë shumë me kushtet e marrëveshjes së detajuar në fund të muajit të kaluar nga presidenti amerikan, Joe Biden, i cili e cilësoi planin si izraelit dhe të cilit disa në Izrael iu referuan si

"marrëveshja e Netanyahu-t". Komentet e tij mund t'i tensionojnë edhe më shumë marrëdhëniet mes Izraelit dhe SHBA-së, aleatit kryesor të tij. Plani me tri faza kërkon lirinë e të gjitha pengjeve të mbetura në

shkëmbim të liritimit të qindra palestinezëve të burgosur në Izrael. Por, ka mosmarrëveshje dhe mosbesim mes Izraelit dhe Hamasit për mënyrën se si do të zbatohet marrëveshja. Hamasi ngul këmbë se nuk do t'i

lirojë pengjet e mbetura, nëse nuk ka armëpushim të përhershëm dhe tërheqje të plotë të forcave izraelite nga Gaza. Kur Bideni e njoftoi propozimin në fund të majit, tha se marrëveshja i përfshin të dyja këto.

Por, Netanyahu thotë se Izraeli është i përkushtuar për ta shfarosur Hamasin dhe për t'u siguruar se ky grup nuk do të kryejë kurrë më sulm si ai më 7 tetor.

Plani përfshin tri faza për t'i dhënë fund luftës me një plan shumëvjeçar për rindërtimin e Gazës, e cila është rrënuar pothuajse plotësisht si pasojë e luftimeve.

Izraeli e nisi luftën në Gazë si përgjigje ndaj një sulmi nga Hamasi në jug të Izraelit më 7 tetor, ku u vranë 1.200 njerëz, kryesisht civilë, dhe u rrëmbyen rreth 250 të tjerë.

Izraeli thotë se më shumë se 100 pengje po mbahen ende në Gazë, së bashku me trupat e pajetë të rreth 30 të tjerëve.

Prej atëherë, lufta izraelite në Gazë i ka vranë më shumë se 37.000 palestinezë, gjysma e të cilëve fëmijë dhe gra, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë. /REL



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**SPORT**  
EURO2024 GERMANY



# Shqipëria me kokën lart eliminohet nga Evropiani, kualifikohen Spanja dhe Italia

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

DUSSELDORF, 24 QERSHOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll është eliminuar nga Kampionati Evropian, por me kokën lartë pasi ka pasur paraqitje të mira në grupin e "ferrit" ku ishin Spanja, Italia dhe Kroacia. Në tri ndeshjet e zhvilluara, kuqezinjtë patën performancë të mirë dhe arritën të nxjerrin barazim ndaj Kroacisë. Në ndeshjen e fundit të zhvilluar në "Merkur-Spiel Arena", të Dyseldorfit, Shqipëria pësoi humbje nga Spanja me rezultat 0-1. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Ferran Torres, në minutën e 13-të. Djelmoshat kuqezi që drejtohen nga Sylvinho nuk arritën dot të përmbysin rezultatin duke e

**GRUPI B**

Shqipëri - Spanjë	0-1
Kroaci - Itali	1-1

**Tabela**

1. Spanja	9 pikë
2. Italia	4
3. Kroaci	2
4. Shqipëria	1

mbyllur në mënyrë më të keqe të mundshme aventurën në Gjermani, pavarësisht se porta spanjolle u kërcënua disa herë nga Asllani e Armando Broja. "E filloj nga ekipi, stafi, të gjithë që kanë qenë të pranishëm. Jam i lumtur për të gjithë ekipin për performancat që kemi treguar në fushë, jo shumë për



ndeshjen e parë, ku u emocionuam. Falënderoj gjithë tifozët që na kanë përkrahur dhe mbështetur kaq shumë në çdo ndeshje. Gjëja më e rëndësishme është të shohim përpara. Patëm një grup ndër më të vështirët. Treguam ndeshje të mira. Kemi bërë gabime, por është një eksperiencë e madhe për ne. Për të gjithë që bënë Evropianin e parë, siç jam edhe unë. Të rinjtë do të mësojnë dhe do të përmirësohen shumë", ka thënë kapiteni Berat

Gjimshiti, pas ndeshjes. Kualifikimin tutje e siguroi Italia falë barazimit në frymën e fundit ndaj Kroacisë (1-1). Në ndeshjen e zhvilluar në "Red Bull Arena", të Lajpcigut, italianët arritën të barazonin në sekondat e fundit, sfidën ndaj Kroacisë, duke u ngjitur në kuotën e 4 pikëve. Të parët në epërsi kaluan kroatët me golin e mesfushorit legjendar, Luka Modriq, i cili vendosi edhe një rekord, teksa shënoi golin në

moshën 38-vjeçare, duke u bërë kështu lojtari më i vjetër në një Kampionat Evropian, që arrin diçka të tillë. Në anën tjetër, pas shumë e shumë tentativash për të barazuar rezultatin erdhi edhe momenti i golit të barazimit, kur në minutën e 98-të të lojës, anësori i Lazio, Mattia Zaçagni dërgoi në rrjetë një pasim të Calafiori, duke siguruar 1 pikë, e cila mjafton për kualifikim tutje. Italia në raundin tjetër përballat me Zvicrën e Shqiptarëve.

## Batatina: Ky do të jetë viti i Llapit

PODUJEVË, 24 MARS - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka komentuar shortin e raundit të parë kualifikues të Ligës së Evropës. Llapjanët aventurën në fazën kualifikuese për në Ligën e Evropës e nisnin kundër skuadrës polake, Wisla Krakow. Në një intervistë për "KosovaPress", trajneri Batatina e cilësoi "gjigant në shtetin e vet", por që edhe skuadra polake do të përballat me një kundërshtar shumë të fortë siç është Llapi. Batatina ka shprehur bindjen se Llapi do të kualifikohet në fazën e grupeve të Ligës së Evropës. Duke folur



për kampionatin e Kosovës në futboll, trajneri Batatina thotë se ky do të jetë viti ku Llapi do të

shpallet kampion. "Gjithmonë vetë organizimi i klubit dhe lojtarët që ka klubi

me kontingjentin të cilin e ka krijuar, mendoj se nuk të lë të mendosh ndryshe përveç luftës për titull të kampionit. Ne kot mund të themi se s'po luftojmë për titull, por Llapi gjithmonë do të luftojë për kreun e tabelës. Llapit iu ka nevojitur të paktën të bëjë një hap tutje që të jetë në hap më shumë se skuadrat në elitën e futbollit të Kosovës. Mendoj se Llapi ka bërë një hap të jashtëzakonshëm, duke e ditur se është kampion me infrastrukturë sportive, që gjëja bazike për një skuadër. Nëse e ke infrastrukturën sportive sikurse e ka Llapi dhe

organizimin të cilin e ka krijuar Llapi, mendoj se nuk ka dyshim se Llapi do të luftojë për titull të kampionit... Pasi kemi qenë shumë afër këtë vit, ndoshta me një hap për t'u bërë kampion, besoj se ky do të jetë viti i Llapit", ka thënë Batatina. Ndeshjen e parë në raundin e parë kualifikues të Ligës së Evropës kundër Wisla Krakowit skuadra e Llapit do ta zhvillojë si vendëse më 11 korrik, kurse ndeshjen e kthimit më 18 korrik. Nëse Llapi e elimonon skuadrën polake, në raundin e dytë do të përballat me skuadrën e njohur austriake SK Rapid Wien.

## Sot fillon FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Basketbolli i Kosovës gjatë kësaj vere do të jetë sporti kryesor në vend, sepse për herë të parë në Kosovë do të organizohet FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla – Femrat, nga data 25 deri 30 qershor 2024, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Qytetarët e Kosovës do ta kenë

rastin që për herë të parë ta shohin Përfaqësuesen A të Kosovës – Femrat duke luajtur në shtëpi në një garë me shtatë shtete të tjera, ku në një konkurrencë shumë të fortë ekipi ynë synon të bëjë më të mirën për të shënuar rezultate sa më pozitive. Në garën e këtij viti do të marrin pjesë tetë shtete, të cilat janë ndarë në dy

ORARI I NDESHJEVE TË KOSOVËS:

25 QERSHOR (20:30)	MALTA - KOSOVA
26 QERSHOR (20:30)	KOSOVA - QIPRO
27 QERSHOR (20:30)	KOSOVA - GJEORGJIA



grupe, Grupi A: Qipro, Malta, Kosova, Gjeorgjia. Ndërsa në Grupi B bëjnë pjesë: Norvegjia,

Shqipëria, Andorra, Armenia. Faza në grup do të zhvillohet tri ditë, me një ditë pushimi më 28

qershor, përpara se gara të kalojë në gjysmëfinale më 29 qershor.



## Kane: Të gjithë duan të na mundin, por mund të shkojmë deri në fund

KOLN, 24 QERSHOR - Anglia përgatitet për ndeshjen e fundit në Grupin C të "Euro 2024", ku kryeson renditjen me 4 pikë pas dy ndeshjeve të para. Kombëtarja e "Tre luanëve" do të luajë ndaj Sllovenisë, një sfidë delikate për skuadrën e

trajnerit Gary Southgate. Harry Kane, sulmuesi i Anglisë, në një intervistë për UEFA-n para kësaj sfide ka deklaruar: "Është kënaqësi që realizova golin tim të parë në këtë turne ndaj Danimarkës edhe pse nuk fituam dot. Gjithsesi, deri më

tani e kam shijuar çdo minutë. Do të ketë ndeshje të tjera sfiduese përpara, siç është ajo që do të luajmë nesër. Ne jemi Anglia dhe kundërshtarët tanë duan të na mundin, por nuk do të jetë e lehtë për të na mposhtur", ka thënë sulmuesi i

Bayernit. "Edhe ne e dimë se nuk do ta kemi të lehtë të fitojmë edhe pse kemi lojtarë të nivelit të lartë. Ne përgatitemi për të fituar dhe mund t'ia dalim mbanë të shkojmë deri në fund ashtu si në turneun e fundit", ka shtuar Kane.



## Leclerc dhe Sainz përplasen mes vete pas garës në Spanjë

BARCELONË, 24 QERSHOR - Gara e Spanjës në Formula 1 ishte disi anonime për Ferrarin, me dy pilotët e saj që e mbyllën garën në po ato vende që e nisën: 5-6. Gjithsesi, "kokëkuqja" tërhoqi vëmendjen pas deklaratave akuzuese që dy pilotët e saj, Charles Leclerc e Carlos Sainz, dhanë pas garës për njëri-tjetrin. Përplasia në mes tyre nisi nga një parakalim i spanjollit ndaj monogaskut: "Parakalimi i Sainz ndaj meje në fillim të garës ishte i pavend. Plani ishte të ruheshin gomat. Unë bëra kthesën e fundit, ai nuk e bëri dhe më pas ai më rrëshqiti. Nuk kishte kuptim të merrja këtë lloj rreziku. Unë pata një dëmtim të vogël në krahun e përparmë që më kushtoi pak kohë. Le të themi se donte të bënte një shfaqje, por kjo më kushtoi një pozicion. Ai mund të kishte bërë diçka ndryshe nga pikëpamja strategjike. Nuk po arrijmë askund me atë që bëjmë,



tani duhet ta analizojmë me kujdes garën tonë", ka thënë Leclerc. Nga ana e tij, Sainz përgjigjet troç: "Ne kishim goma të buta të reja në fillim, Mercedesi i kishte të përdorura, kështu që duhej të sulmonim menjëherë. Charles bëri një gabim dhe shfrytëzova rastin. Nuk e di se për çfarë duhet të ankohet Charles. Nuk është se mund të pres të

qëndroj pas tij gjatë gjithë jetës. Prisja një rezultat më të mirë këtu në Barcelonë, për të qenë pak më afër podiumit. Red Bull dhe McLaren janë larg dhe në pista si kjo, Mercedesi duket se është përpara nesh. Në pistat si ajo e radhës, në Spielberg, në pistat me shpejtësi të mesme, ne luftojmë më shumë se kundërshtarët tanë", ka thënë Sainz.

## Sinner fiton 'ATP Halle' dhe siguron numrin 1 të botës

SAN CANDIDO, 24 QERSHOR - Tenisti italian Jannik Sinner ia doli të triumfojë edhe në turneun e fundit parapërgatitës "ATP" për Slam-in e radhës, Wimbledon. Sinner arriti të mposhtë në finale polakun Hubert Hurkacz me rezultatin 2-0 (7-6, 7-6). Një ndeshje e fortë që zgjati për gati 2 orë pa tenisistët që luftonin për çdo pikë.

Në fund, fati i buzëqeshi numrit 1 të botës, me Sinner që rikonfirmohet pretendenti kryesor për turneun e "Wimbledonit" dhe kësaj rivali për t'u mundur. Pas kësaj finaleje, Sinner mori një lajm shumë të mirë në nisje të eventit më të madh të verës. Jannik do të vazhdojë të jetë numri 1 i botës edhe pas Wimbledonit. Një gjë e tillë e bën Sinner edhe me më shumë motiv, pasi nuk do ta ketë presionin e rivalëve për t'ia marrë vendin e parë. Pas ndeshjes, tenisti nga Tiroli i Jugut nuk e fshehu entuziazmin dhe deklaroi se në Londër kërkon të jetë fitues: "Sfidë e vështirë, fitore fantastike dhe ndjenjë shumë e



mirë. Tani fillon 'Wimbledon'. Mezi po pres. Kam luajtur mirë duke arritur gjysmëfinalen. Të shohim këtë vit. Ka shumë pak diferenca nga turneu në turne. Shpresoj për një kompeticion të mirë nga ana

ime dhe të jem fitues", u shpreh 22-vjeçari. Slami i Wimbledonit do të nisë më datë 1 korrik dhe do të mbërthejë të apasionuarit pas tenisit deri më 14 korrik, me finalen e madhe në Londër.

### SHKURT

#### Khaka, lojtari më i mirë i ndeshjes Gjermani - Zvicër

Gjermania dhe Zvicra kanë barazuar me rezultat 1-1 në ndeshjen e fundit të fazës së grupeve në kuadër të Grupit A në "Euro 2024". Ndeshja ishte e bukur dhe me raste nga të dyja anët, por që skuadrat u desh të pajtohen me barazim. Dan Ndoye shënoi golin e parë në ndeshjen për Zvicrën, ndërsa Niclas Füllkrug barazoi shifrat për gjermanët. UEFA ka zgjedhur lojtarin e ndeshjes, duke vendosur për mesfushorin fantastik dhe kapitenin e Zvicrës, Granit Xhakën. "Xhaka me sa duket ka qenë kudo sonte. Nga ndihma për ta çuar topin përpara deri te mbrojtja dhe shpejtësi që harkimet e Gjermanisë të mos hyjnë në zonë. Kapitani ka qenë edhe një herë një nga figurat më të spikatura", shkruante UEFA në faqen e tyre zyrtare. Ai vrapoi pothuajse 12 kilometra, ndërsa në një moment arriti shpejtësi prej 31.4 km/h. Saktësia e pasimeve ishte 84 për qind. Hera e dytë që Granit Xhaka e fiton këtë çmimin në Euro 2024, gjë që e bëri edhe ndaj Hungarisë në fitoren 3-1. Zvicra kalon tutje e dyta e grupit me 5 pikë, ndërsa Gjermania e para me 7 pikë.

#### Neueri shkruan historinë, portieri i vetëm që numëron 18 paraqitje në Evropian

Manuel Neuer është një legjendë e futbollit dhe i shton një rekord të ri karrierës. Portieri i Bayernit München dhe i kombëtares gjermane, që luajti të dielën në mbrëmje kundër Zvicrës, u bë portieri me më shumë paraqitje në historinë e kampionateve evropiane. Neueri numëron kështu paraqitjen e tij të 18-të në Evropian, një më shumë se Gianluigi Buffon dhe dy më shumë se Edwin van der Sar.

#### Deschamps: Mbappe mund të luajë ndaj Polonisë

Trajneri i Francës, Didier Deschamps, ka dhënë një intervistë për kanalet zyrtare të kombëtares franceze. Ai ka folur për gjendjen e Kylian Mbappes, i cili pësoi thyerje të hundës pas një goditjeje kundër Austrisë në ndeshjen e parë në grup. Në takimin e dytë sulmuesi i ardhshëm i Real Madridit nuk u aktivizua, por ai pritet të jetë në fushë ndaj Polonisë së eliminuar nga "Euro 2024". Të paktën për disa minuta apo një pjesë loje. "Do të ketë ende teste për të parë se si do të evoluojnë gjërat. Tronditja që ai dhe të gjithë në pësuam ishte e dukshme. Stafu mjekësor bëri atë që ishte e nevojshme për ta reduktuar atë sa më shumë. Kylian tani është më mirë, është stërvitur me maskë dhe do ta shohim gjendjen e tij me kujdes para se të vendosim. Kemi edhe një ditë kohë, por pushimi i bëri mirë për t'u qetësuar", ka thënë Deschamps.

#### Milani në gjurmët e sulmuesit të Evertonit, kushton 20 milionë euro

Sulmuesi anglez Dominic Calvert-Lewin do të largohet nga Evertoni këtë verë edhe pse ka ende një vit kontratë (deri qershor 2025). 27-vjeçari, që luan prej 8 sezonesh me Everton, ka realizuar 68 gola në 248 ndeshje zyrtare në Premierë Ligë. Në gjurmët e tij janë vënë Newcastle dhe, së fundi, Milani, lajm që konfirmohet nga e përditshmja britanike "Daily Mail". Kuqezinjtë janë në kërkim të një sulmuesi të parë pas largimit të Olivier Giroud. Milan ka bërë mjaft transferime nga Anglia sezonin e fundit dhe sulmuesi Calvert-Lewin mund të jetë ai i radhës. Kostoja e transferimit të tij është 20 milionë euro, por kjo shumë mund të ulet duke qenë se ai nis vitin e fundit të kontratës. Për Milanin mund të jetë një blerje me kosto të pranueshme, një lojtar që e njeh mirë zonën kundërshtarë. Mësohet se bisedimet kanë nisur mes kuqezinjve dhe lojtarit, për ta bindur të transferohet në Serinë A.

## Fenerbahçe synon transferimin e Sterlingut

Fenerbahçe, pasi arriti marrëveshje me Jose Mourinhon, tashmë ka nisur të mendojnë për merkaton e verës, e cila pritet të jetë intensive dhe me emra të mëdhenj, për t'i

plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme që "Special One" të arrijë lavdinë në Turqi. Milionat duket të mos jenë aspak problem për skuadrën nga Stambolli dhe mediet turke kanë

filluar të zbulojnë disa emra, që lidhen ngushtë me një kalim të "gigantët" e Stambollit, me të parin në listën e "Fenerëve", që është një lojtar i cili ka fituar jo pak në elitën e futbollit anglez,

Premierë Ligë, me skuadra si Liverpool, Manchester City e Chelsea. Bëhet fjalë për anësorin anglez Raheem Sterling, të cilit klubi turk është i gatshëm t'ia plotësojë çdo dëshirë 29-

vjeçarit. Tifozët e Fenerbahçes presin rikthimin e titullit kampion, që mungon prej vitit 2014 dhe duket se sezoni i ardhshëm do t'i rikthejë "Fenerët" te lavdia.





Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.2371 të datës 25.06.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 25.06.2024 shpall:

### KONKURS I BRENDSHËM

**Pozita e punës: Kontrollor i komunikacionit**

**Numri i pozitave: 1**

**Niveli i pagës: XV**

**Kohëzgjatja e kontratës: Ne afat të pacaktuar**

**Kualifikimet: Shkollim i Mesëm**

**Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune**

**Periudha provuese: 3 muaj**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kontrollon sipas vlerësimit apo orarit nga Shefi i Kontrollës në autobusët e ndërmarrjes në çdo kohë dhe në çdo vend sipas dispozitave ligjore (aty ku nuk pengohet trafiku);
- Kontrollon udhëtarët, stafin e autobusëve (shoferët dhe konduktoret) e ndërmarrjes në çdo kohë dhe në çdo vend duke respektuar dispozitat ligjore në komunikacion, aty ku nuk e pengon trafikun;
- Sipas udhëzimeve të Përgjegjësit të Kontrollës, kontrollon orarin e punës së dispeçerëve të linjave si dhe orarin e qarkullimit të autobusëve;
- Kontrollon qëndrimin, përgatitjen dhe dukjen për punë të dispeçerëve dhe stafit të autobusit (shoferëve dhe konduktoret) si dhe pastërtinë brenda dhe jashtë autobusëve;
- Kryen regjistrime të rregullta dhe të jashtëzakonshme për të gjithë llogaridhënësit (shoferëve, fletë-udhëtimet e autobusëve, konduktoret);
- Kryen kontrollin gjatë punës së rregullt të konduktoret dhe verifikon pajisjen e udhëtarëve me kuponë fiskal dhe bileta të tjera të lëshuara nga persona të autorizuar të ndërmarrjes, verifikon origjinalitetin e kuponëve fiskal-biletave, fletë-urdhësesave të udhëtimit, fletë-udhëtimet tek relacionet e kontraktuara dhe në rast parregullsie ndërmerr masa të nevojshme për iniciimin e procedurave duke shkruar fletëparaqitje;
- Verifikon nëse konduktoret posedojnë të hollat e paguara nga udhëtarët në emër të kuponëve fiskal të shitur;
- Vërteton se shoferët dhe konduktoret janë duke qarkulluar në relacionin e caktuar dhe në kohë sipas orarit të lëshuar nga personat e autorizuar të ndërmarrjes;
- Vërteton nëse shoferi i autobusit posedon patentë shoferin, urdhëresën e rrugës së nënshkruar nga kontrollori teknik i ndërmarrjes, si dëshmi e gatishmërisë së autobusëve për qarkullim në trafik;
- Është i obliguar të ndal autobusin me shenjë "STOP" në vendin ku nuk pengon qarkullimin në trafik;
- Kontrollori shqipton gjoja për qytetarët të cilët gjenden në autobus dhe kanë humbur apo nuk kanë paguar biletën e autobusit;
- Kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kërkohen nga mbikëqyrësi;
- Për punën e tij i përgjigjet Përgjegjësit të Njesisë së Kontrollës së Brendshme Inspektuese.

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Shkollim i Mesëm;
- Të ketë njohuri të mira për çështjet teknike të autobusit.
- Përvoja e punës në pozitën e Kontrollorit të komunikacionit është përparësi.
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup nën presion;

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm

**Informata të përgjithshme:**

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë punëtorët e rregullt të NPK "Trafiku Urban" SHA. -Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data **25.06.2024** dhe përfundon më datë **09.07.2024** në ora **24:00**.

**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **15.08.2024**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.06.2024

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 (0) 45 10 11 23



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.2375 të datës 25.06.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 25.06.2024 shpall:

### KONKURSI JASHTËM

**Pozita e punës: Arkatar**

**Numri i pozitave: 1**

**Niveli i pagës: XVI**

**Kohëzgjatja e kontratës: Ne afat të pacaktuar**

**Kualifikimet: Diplomë Universitare**

**Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune**

**Periudha provuese: 3 muaj**

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

Ne lidhje me pozitën e punës i gjeni në web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com), në vegzën - Rreth nesh. Raporte/[Rregullore](#)

**Përgatitja profesionale:**

- Diplomë universitare - Fakulteti Ekonomik
- 1 vit përvojë pune
- Aftësi shumë të mira të punës me kompjuter;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

**Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data **25.06.2024** dhe përfundon më datë **09.07.2024** në ora **24:00**.

**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **15.08.2024**.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.06.2024



U skladu sa članom 8. Zakona br. 03/L-212 člana 5, 7 i 8 Administrativnog uputstva br.01/2024 o pravilima i procedurama konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), tačka 10 tačka 1,5 i 11 tačka 1 od Uredba br.1074 od 21.08.2017 godine o nalazu na radu i Rešenje br.2375 od 25.06.2024 godine, NPK "Trafiku Urban"SHA– Priština, od 25.06.2024

### JAVNI KONKURS

**Radno mesto:** Blagajnik

**Broj pozicija: 1**

**Visina plate: XVI**

**Trajanje ugovora:** Neograničeno

**Kvalifikacije:** Univerzitetska diploma

**Radno iskustvo:** 1 godina radnog iskustva

**Probni period:** 3 meseca

**Dužnosti i odgovornosti:**

Što se tiče radnog mesta, možete ga pronaći na sajtu: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com), u kartici - O nama, Izveštaji/Pravilnik

**Stručna priprema:**

- Ekonomski fakultet
- 1 godina radnog iskustva
- Veoma dobro poznavanje rada na računaru;
- Dobre organizacione i komunikacione veštine;
- Profesionalna etika i biti sposoban da radi pod pritiskom.Potrebnia dokumentacija.

**Potrebnia dokumentacija:**

Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;

- CV
  - Dokaz o obrazovanju;
  - Kopija lične karte;
  - Dokaz o dokazanom radnom iskustvu u Trustu;
  - Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
  - Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurirate su prednost.
- Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna izmena informacija datih u gornjoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

**Opšte informacije:**

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

**Način primene:**

Prijava se može izvršiti samo putem mejla: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkurs je otvoren od **25.06.2024** i završava se **09.07.2024** u ponoć.

Okvirni kalendari izrade procedura: Nakon okončanja procedura otvaranja konkursa, planirano je da se procedure izrade završe najkasnije do **15.08.2024**.

**Način vrednovanja kandidata/prijavljenih**

- Pismeni test – maksimalno 70 poena
- Intervju – maksimalno 20 poena
- CV – maksimalno 10 bodova

**Napomena:** Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.

Datum: 25.06.2024





Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.2370 të datës 25.06.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 25.06.2024 shpall:

## KONKURSI JASHTËM

**Pozita e punës: Mbushës i Derivateve dhe Fluideve**

**Numri i pozitave:** 1

**Niveli i pagës:** XVII

**Kohëzgjatja e kontratës:** Ne afat të pacaktuar

**Kualifikimet:** Shkollim i Mesëm

**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune

**Periudha provuese:** 3 muaj.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Ne lidhje me pozitën e punës i gjeni në web: [www.trafikurban-pr.com\\_në vegzën Rreth neshh. Raporte/ Rregullore](http://www.trafikurban-pr.com_në_vegzën_Rreth_neshh_Raporte/Rregullore)

**Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Shkollim i mesëm nga fusha e teknikës, ekonomisë apo logjistikës 1 vit përvojë pune në fushën përkatëse;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit;

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune> ;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlihen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data 25.06.2024 dhe përfundon më datë 09.07.2024 në ora 24.00.

**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më 15.08.2024.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.06.2024



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr.1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.2374 të datës 25.06.2024, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më date 25.06.2024 shpall:

## KONKURSI JASHTËM

**Pozita e Punës: Punëtor Sigurimi**

**Numri i pozitave:** 1

**Niveli i Pagës:** XXI

**Kohëzgjatja e kontratës:** Ne afat të pacaktuar

**Kualifikimet:** Shkollim i mesëm

**Përvoja e punës:** 1 vit përvojë pune

**Periudha provuese:** 3 muaj

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: [www.trafikurban-pr.com\\_në vegzën - Rreth Neshh, Raporte/Rregullore](http://www.trafikurban-pr.com_në_vegzën_Rreth_Neshh_Raporte/Rregullore).

**1. Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Diplomë e shkollës së mesme, licencë për Sigurim Fizik
- Përvojë pune 1 vit
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë disiplinore.

**2. Dokumentacioni i kërkuar:**

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune> ;
- CV
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlihen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

**Informata të përgjithshme:**

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

**Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkursi është i hapur nga data 25.06.2024 dhe përfundon më datë 09.07.2024 në ora 24.00.

**Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave:** Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më 15.08.2024.

**Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 25.06.2024

NPK " Trafiku Urban" SHA  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33

1



U skladu sa članom 8. Zakona br. 03/L-212 člana 5, 7 i 8 Administrativnog uputstva br.01/2024 o pravilima i procedurama konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), tačka 10 tačka 1,5 i 11 tačka 1 od Uredba br.1074 od 21.08.2017 godine o nalazu na radu i Rešenje br.2370 od 25.06.2024 godine, NPK „Gradski saobračaj“ dd – Priština, od 25.06.2024

## JAVNI KONKURS

**Radno mesto:** Punjač derivata i fluida

**Broj pozicija:** 1

**Visina plate:** XVII

**Trajanje ugovora:** Neograničeno

**Kvalifikacije:** Srednje obrazovanje

**Radno iskustvo:** 1 godina radnog iskustva

**Probni period:** 3 meseca.

**Dužnosti i odgovornosti:**

Što se tiče radnog mesta, možete ga pronaći na sajtu: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com), u kartici - O nama, Izveštaji/Pravilnik

**Dužnosti i odgovornosti:**

Što se tiče radnog mesta, možete ga pronaći na sajtu: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com), u odeljku O nama, Izveštaji/Pravilnik

**Kvalifikacije i veštine:**

- Srednja stručna sprema iz oblasti tehnologije, ekonomije ili logistike, 1 godina radnog iskustva u odgovarajućoj oblasti;
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- da se protiv podnosioca prijave ne vodi krivični postupak;

**Potrebna dokumentacija:**

Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;

- CV
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o dokazanom radnom iskustvu u Trustu;
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurirate su prednost.

Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna izmena informacija datih u gornjoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

**Opšte informacije:**

Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

**Način primene:**

Prijava se može izvršiti samo putem mejla: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com)

Konkurs je otvoren od 25.06.2024 i završava se 09.07.2024 u ponoć.

